

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. KORÇË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Korçë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 3, datë 05.01.2015.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.200, me shkresën nr. 687/10, datë 05.01.2015 dërguar Z. Petrit Tare, Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Korçë, shkresën nr. 687/11, datë 05.01.2015 dërguar Këshillit Mbikëqyrës dhe shkresën nr. 687/13, datë 06.01.2015 dërguar Agjencisë së Prokurimit Publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Gjetja nga auditimi

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” sh.a. Korçë, ka përcaktuar pagat e anëtarëve të këtij këshilli në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar pika 6,” c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.2. Rekomandimi

Këshilli Mbikëqyrës të marri masa për përcaktimin e drejtë të shpërblimit të anëtarëve të këtij këshilli konform VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime” si dhe të Udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6.

Menjëherë

2.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën e audituar, Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” sh.a Korçë, marrëdhëniet e punës midis punëdhënësit e punëmarrësit, marrëdhëniet me sindikatat nuk ishin të rregulluara me Kontratën Kolektive të Punës për arsye se kishte mbaruar afati i saj.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2. Rekomandimi

Drejtori i Përgjithshëm dhe departamentet përkatëse të marrin masa për përsëritjen e Kontratës kolektive të punës në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 168.

Menjëherë

3.1. Gjetja nga auditimi

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm në 8 rastet e sponsorizimeve me vleftë 1,164,000 lekë ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar dhe Statutin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjellës Kanalizime” Korçë, neni 15, pika 2, germa “a”, duke kryer pagesat e mësipërme pa marrë më parë miratimin nga ana e Këshillit Mbikëqyrës. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 100-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.2. Rekomandimi

Këshilli Mbikëqyrës i UKKO të marrë në analizë pagesat e mësipërme për të nxjerrë

përgjegjësinë si dhe në sponsorizimet për të ardhmen të kërkoj zbatimin e ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar dhe Statutin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjiellës Kanalizime” Korçë, neni 15, pika 2, germa “a”.

Menjëherë

4.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën e audituar, Departamentet e Shoqërisë në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, nuk kanë hartuar dhe dërguar për miratim në Asamblenë e Aksionarit, programin ekonomiko-financiar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 21-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.2. Rekomandimi

Drejtoria e shoqërisë të hartojë, miratojë dhe të dërgojë në institucionet e prore programe ekonomiko-financiar me tregues të harmonizuar dhe të bashkërenduar, duke ndjekur të gjitha fazat përkatëse, si dhe periodikisht të analizojë ecurinë e tyre, duke përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e gjendjes dhe realizmin e tyre.

Vazhdimisht

5.1. Gjetja nga auditimi

Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” sh.a Korçë nuk ka miratuar pasqyrat financiare të viteve ushtrimore 2012 dhe 2013 në Asamblenë e Aksionarit, për sa i përket realizimit të ardhurave, shpenzimeve materiale, fitimit, gjendjes së debitorëve, realizimin e investimeve etj, në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 21-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.2. Rekomandimi

Këshilli Mbikëqyrës, Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe Departamenti i Financës të marrin masa për miratimin e pasqyrave financiare në Asamblenë e Aksionarit, për realizimin e treguesve sipas programit ekonomik të zhvillimit, për realizimin e investimeve, të fitimit si dhe tregues tjetër që i shërben njohjes së situatës ekonomiko financiare të shoqërisë.

Menjëherë

6.1. Gjetja nga auditimi

Nga ana e Drejtorisë Ekonomike për periudhën e audituar, janë kryer pagesa nëpërmjet arkës në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, germa “e” dhe udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 64. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 92-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.2. Rekomandimi

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të merren masat e duhura për eliminimin e pagesave e arkëtimeve nëpërmjet arkës në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, germa “e” dhe udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 64.

Menjëherë

7.1. Gjetja nga auditimi

Ka munguar bashkërendimi i punës midis departamenteve, për të programuar saktë nevojat për prokurimet me vlera të vogla për punë, mallra dhe shërbime, të përcaktojnë grup mallra e shërbime sipas natyrës së përdorimit, për të shmangur copëzimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit me efektivitet, transparencë dhe konkurrencë të operatorëve ekonomikë, për të marrë masat e nevojshme për zbatimin e procedurave të prokurimit publik për blerje me vlera të vogla në kryerjen e shpenzimeve për blerje bileta udhëtimi jashtë vendit, si dhe likuidimin e shpenzimeve të bëhet me plotësimin e të gjithë dokumentacionit ligjor përkatës dhe të ndiqen blerjet e vogla për grup artikuj, mallrash apo shërbimesh sipas

regjistrin të prokurimit.

Blerjet me vlera të vogla janë kryer duke mos mbajtur parasysh regjistrin e prokurimeve me vlera të vogla për periudhën e audituar, duke mos respektuar limitin ligjor të blerjeve për grup apo artikuj prej 400 mijë lekë, për periudhën e audituar ky limit është tejkaluar sipas grupeve të mallrave apo artikujve për 8,230,672 lekë dhe për pasojë duhej të zhvilloheshin procedurat përkatëse për prokurimin e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, germa “a”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2012, “Për blerjet me vlera të vogla” i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 92-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.2. Rekomandimi

Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë së bashku me Departamentet të marrin masa, që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen vetëm mbi bazën e një argumentimi ligjor për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure si dhe të ndjekjes në vazhdimësi të realizimit të regjistrin të prokurimit me vlera të vogla.

Vazhdimisht

8.1. Gjetja nga auditimi

Në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Korçë sh.a nuk janë marrë masat e nevojshme për miradministrimin e shpenzimeve për karburant, duke përcaktuar dhe plotësuar fletë udhëtimet për çdo mjet transporti, autoveturë e mjete të tjera të rënda si eskalatorë, vinç, kaldajën, që të pasqyrojnë kilometrat e përshkruara prej tyre, cilësimin e destinacionit dhe distancave, si dhe orët e punës e normativat e harxhimit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 152-159, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.2. Rekomandimi

Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Teknike e të Shërbimeve të marrin masa për miradministrimin e shpenzimeve për karburantin nëpërmjet përcaktimit të drejtë e real të normativave të harxhimit të karburantit për çdo mjet si dhe të plotësimit të fletëve të udhëtimit, të përcaktimit të distancave rrugore e destinacionit të lëvizjes së tyre.

Menjëherë

9.1. Gjetja nga auditimi

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Korçë, të marrë masa për të plotësuar mangësitë e konstatuara në dosjet e prokurimit sipas legjislacionit përkatës duke u bazuar në azhurnimet e vazhdueshme të ligjit për prokurimin publik dhe në rregullat për prokurimin publik, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 35-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.2. Rekomandimi

Nga ana e departamenteve përkatëse, njësisë së prokurimit, të bëjnë plotësimin e mangësive të konstatuara në dosjet e prokurimit sipas legjislacionit përkatës duke u bazuar në azhurnimet e vazhdueshme të ligjit për prokurimin publik dhe në rregullat për prokurimin publik, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

10.1. Gjetja nga auditimi

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, UKKO SHA, nuk ka marrë masa që të trajnojë anëtarët e njësisë së prokurimit të paktën njëherë në vit, për çështjet

e prokurimit publik nëpërmjet mbikëqyrjes nga APP–ja. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 35-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.2. Rekomandimi

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Korçë sh.a, të marri masa që të trajnojë anëtarët e njësisë së prokurimit të paktën njëherë në vit, për çështjet e prokurimit publik nëpërmjet mbikëqyrjes nga APP–ja, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vazhdimisht

11.1. Gjetja nga auditimi

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, të bëhet i mundur krijimi i procedurave që nxisin konkurrencën, justifikojnë ndjekjen e procedurave standarde të prokurimit për të dhënë mundësinë e marrjes sa më shumë të operatorëve në procedurat e prokurimit publik në kushte të barabarta konkurruese. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 35-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.2. Rekomandimi

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Korçë sh.a, të marri masa për të zhvilluar procedura prokurimi që nxisin konkurrencën dhe që justifikojnë ndjekjen e procedurave standarde të prokurimit mbi ose nën kufirin e ulët monetar, kushte këto që i japin mundësi sa më shumë operatorëve në marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik në kushte të barabarta konkurruese.

Vazhdimisht

12.1. Gjetja nga auditimi

Në zbatim të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e realizimin e programit ekonomik të zhvillimit dhe kryesisht për realizimin e investimeve të programuara, nga ana e departamenteve përkatëse ky tregues nuk është vlerësuar drejt si një tregues për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve e të rritjes së fitimit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.2. Rekomandimi

Drejtori i Përgjithshëm dhe departamentet përkatëse të marrin masa për rritjen e shkallës së realizimit të investimeve të programuara.

Vazhdimisht

13.1. Gjetja nga auditimi

Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë në bashkëpunim dhe me departamentet, nuk kanë kryer analizë të hollësishtme mbi gjendjen e debitorëve, nuk ka ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit ndaj subjekteve debitore, nuk i është paraqitur për analizë të mëtejshme Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Aksionarit në kundërshtim me ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 20-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.2. Rekomandimi

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë, si dhe departamentet, të analizojnë gjendjen e debitorëve, të marrin masat e nevojshme të menjëhershme për reduktimin e tyre, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, në zbatim të ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002.

Vazhdimisht

14.1. Gjetja nga auditimi

Drejtoria e departamentet e shoqërisë në asnjë rast nuk kanë marrë në analizë rritjen e sasisë së faturuar, uljen e shkallës së humbjes, nuk ka marrë në analizë punën për rritjen e konsumatorëve nëpërmjet rritjes së numrit të kontratave si dhe rritjen e numrit të abonentëve. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 20-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.2. Rekomandimi

Drejtori i përgjithshëm dhe departamentet përkatëse të marrin masa për rritjen e sasisë së ujit të faturuar dhe uljen e shkallës së humbjeve duke rritur numrin e kontratave dhe duke rritur numrin e abonentëve.

Vazhdimisht

15.1. Gjetja nga auditimi

Drejtoria dhe departamentet e shoqërisë të bashkërendojnë punën midis tyre për arritjen e objektivave të përcaktuara në programet e zhvillimit të shoqërisë nëpërmjet rritjes së efikasitetit të zbatimit të ligjit nëpërmjet auditimeve të përbashkëta e krijimit të hapësirave të nevojshme sipas ligjit për auditin e brendshëm. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 106-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.2. Rekomandimi

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë UKKO në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, Drejtorinë Teknike dhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për përgatitjen dhe nënshkrimin të deklaratës për periudhën në vazhdim mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në zbatim të ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011 "Mbi përgatitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike" gjatë vitit të mëparshëm dhe në vazhdim, për entitetin publik që mbulon, gjithashtu të marrë masa për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo-financiare të entit si dhe të mbështesë strukturat drejtuese të UKKO SHA, në arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të shoqërisë.

Vazhdimisht

16.1. Gjetja nga auditimi

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për tenderët e audituar kanë rezultuar mangësi që kanë të bëjnë me s`kualifikim operatorësh me arsyetimin e mosparaqitjes së ofertës ndërkohë që në sistemin elektronik rezulton e paraqitur, janë kualifikuar operatorë me dokumentacion më të hershëm se përcaktimet e DST, është s`kualifikuar për mungesë dokumentacioni një operator ekonomik ndërkohë që në procedurën e dytë është kualifikuar me të njëjtin dokumentacion, KVO nuk kishte në përbërje specialistë të fushës, specifikimet teknike të mallit të lëvruar ndryshonin me ato në kontratë, kushtet e përgjithshme të kontratës nuk janë të nënshkruara në të gjitha fletët nga titullari i autoritetit kontraktor. Titullari i autoritetit kontraktor nuk ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim, operatorët ekonomikë fitues i kanë sjellë dokumentet dorazi, si dhe nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 35-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.2. Rekomandimi

Drejtoria e shoqërisë, t`i kushtojë vëmendje e duhur procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga komisionet e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, për ngritjen e komisionit të pranimit dhe kolaudimit të materialeve dhe pajisjeve, në zbatim të kontratave respektive të prokurimeve, për inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit origjinal të operatorëve ekonomikë, si dhe për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, në mënyrë që të sigurohet konkurrenca e nevojshme.

17.1. Gjetja nga auditimi

Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe kërkesat e Kodit të Punës, duke i harmonizuar ato me Kontratën Kolektive të Punës dhe aktet e tjera të shoqërisë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 102-106 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.2. Rekomandimi

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë UKKO, të marrin masa që për nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të zbatojnë kërkesat e ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe kërkesat e Kodit të Punës, duke i harmonizuar ato me Kontratën Kolektive të Punës dhe aktet e tjera të shoqërisë.

Menjëherë

18.1.Gjetja nga auditimi

Në Relacionet shpjeguese për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të hartuar nga kjo ndërmarrje dhe të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimet nr. 8, datë 27.12.2011 “Mbi miratimin e Programit Ekonomik të vitit 2012”, nr. 1, datë 24.12.2012 “Mbi miratimin e Programit Ekonomik të vitit 2013” dhe nr. 1, datë 21.03.2013 “Mbi miratimin e plan biznesit për vitet 2013-2017” **nuk** është bërë një ndjekje dhe analizë e saktë e sistemit të furnizimit me ujë e cila realizohet e gjitha në mënyrë automatike dhe monitorohet nga ujë matësit në prodhim, në rezervuarë, si dhe ato zonale në rrjetin shpërndarës. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 21-25 dhe 133-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.2. Rekomandimi

Nga drejtoria e shoqërisë Relacionet shpjeguese për miratimin e programeve të Zhvillimit Ekonomik për planifikimin e humbjeve në rrjet të hartohen me grupe pune të përbërë nga Departamenti Administrativ dhe Departamenti i Shërbimeve Ujësjiellës, në bazë të një analize të thellë të gjithë faktorëve teknik dhe menaxheriale që ndikojnë në humbjet e ujit në rrjet, me synim për rritjen e koeficientit prodhim faturim.

Vazhdimisht

19.1. Gjetja nga auditimi

Nga mosndjekja dhe kryerja e analizave mujore të humbjeve në rrjet e cila ka bërë që të tejkalohen kufijtë e miratuar në Këshillin Mbikëqyrës kjo shoqëri ka miratuar për vitin 2012 humbjet në rrjet në masën prej 15 % dhe në fakt janë realizuar 28,32 % dhe për vitin 2013 humbjet në rrjet nga 22,8 % të planifikuara në fakt janë realizuar 25,47 %, kurse për 9/mujorin janë realizuar 26,5 %.

Humbjet në rrjet rezultojnë:

a. Për vitin 2012 prej **1,000,873 m³** ujë me **72,162,943 lekë** ose **28,32 %** e prodhimit.

b. Për vitin 2013 prej **834,596 m³** ujë me **58,890,022 lekë** ose **25,47 %** e prodhimit dhe

c. Për 9/mujorin 2014 prej **627,979 m³** ujë me **47,286,818 lekë** ose **25,28 %** e prodhimit.

Në total rezultojnë **2,463,448 m³ ujë** me **178,339,783 lekë** ose **26,5 %** e prodhimit.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 133-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.2 Niveli i prioritetit. Vlera e mësipërme në shumën **178,339,783 lekë lekë** ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

19.2. Rekomandimi

Të analizohet çdo muaj humbjet në rrjet duke nxjerrë përgjegjësinë konkrete sipas departamenteve dhe të përcaktohen detyra konkrete për rritjen e koeficientit prodhim faturim në mënyrë që të ulet kosto operative e prodhimit të ujit.

Vazhdimisht

20.1. Gjetja nga auditimi

Për vitet proces auditimi nuk është bërë bilanci i ujit të dalë nga 2 rezervuarët e grumbullimit të ujit pranë stacionit të pompimit, i cili pompohet në dy linja tubacionesh transmetimi paralele me diametër DN 400 mm dhe me gjatësi rreth 6 km secili tubo gize sferoidale për në 3 rezervuarët në kodrat e qytetit të Korçës. Pra nuk është llogaritur humbja në rrjet e linjave të transmetimit (bilanci dalje nga rezervuarët e ujit në prodhim me hyrjen në 3 rezervuarët në kodrat e qytetit). Kjo do të bënte të mundur për të matur humbjen e sasisë së ujit në rrjetin e transmetimit. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 133-139, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.2. Rekomandimi

Të ndiqet vazhdimisht dhe të analizohet çdo muaj në drejtorinë e shoqërisë humbja në rrjet e linjave të transmetimit (bilanci dalje nga rezervuarët e ujit në prodhim me hyrjen në 3 rezervuarët në kodrat e qytetit).

Vazhdimisht

21.1. Gjetja nga auditimi

Nuk është matur dhe llogaritur sasia e ujit për të bërë pastrimin e rezervuarëve në kodrat e qytetit. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 133-139, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.2. Rekomandimi

Me grup pune të kryhet organizimi duke u matur dhe llogaritur sasia e ujit e cila do të shpenzohet për pastrimin e rezervuarëve, në mënyrë që të saktësohet shpenzimi u ujit për këtë proces teknologjik me synim uljen në vazhdimësi të tij.

Çdo 6/muaj

22.2. Gjetja nga auditimi

Nuk është llogaritur sasia e ujit në dalje nga 3 rezervuarët në kodrat e qytetit në rrjetin **shpërndarës** për qytetin e Korçës, për fshatin Turan dhe fshatin Çiflig **dhe sasisë** së faturuar për të llogaritur saktësisht sasinë e humbjes së ujit në rrjetin e shpërndarjes, në këto fshatra. Nga UKKO nuk është marrë informacion për numrin e familjeve në bazë komune (Për fshatrat Turan dhe Çiflig) për të bërë të mundur spontimin me familjet që kanë lidhje me rrjetin e ujësjellësit dhe kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 133-139, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.2. Rekomandimi

Në mënyrë që të saktësohet sasia e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për fshatrat Turan dhe Çiflig, të llogaritet sasia e ujit në dalje nga 3 rezervuarët në kodrat e qytetit në rrjetin shpërndarës për furnizimet e fshatrave Turan dhe Çiflig.

Nga UKKO të merret informacion për familjet që banojnë në fshatrat e mësipërm dhe me grup pune të kryhet spontimi i familjeve që kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri.

Vazhdimisht

23.1. Gjetja nga auditimi

Nga UK Korçë nuk është marrë numri i familjeve në Gjendjen Civile të Bashkisë Korçë, për të bërë të mundur gjykimin sa më të drejtë në drejtim të humbjeve në rrjet si pasojë e konsumit të ujit nga familjarët pa kontratë.

Gjatë periudhës së auditimit u mor numri i familjeve në Gjendjes Civile të Bashkisë Korçë nga ku rezulton prej 28,343 familje, nga të cilat rezulton se me UKK për vitin 2012 janë lidhur 19,661 kontrata për vitin 2013 janë lidhur 19,875 kontrata dhe për 9/mujorin janë lidhur 20,123 kontrata. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 135-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.2. Rekomandimi

Në mënyrë që të gjykohet sa më drejtë në drejtim të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes nga

shoqëria të merret në mënyrë analitike familjet në Gjendjen Civile të Bashkisë Korçë dhe të spontohen me familjet që kanë lidhur kontratë dhe familjet që nuk kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë. Kjo do të bëjë për të verifikuar dhe saktësuar diferencën prej 8,220 familje që rezultojnë më i madh në gjendjen civile në krahasim me numrin e familjeve të cilat rezultojnë në fund të 9/Mujorit 2014 të cilat kanë lidhur kontratë për furnizim me ujë.

Deri më 30.06.2015

24.1. Gjetja nga auditimi

Nga UK Korçë nuk është marrë numri i familjeve që kanë lidhur kontratë me OSSH, kjo të krahasohesh me numrin e familjeve që kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri, për të bërë të mundur gjykimin sa më të drejtë në drejtim të humbjeve në rrjet si pasojë e konsumit të ujit nga familjarët pa kontratë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 133-139, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.2. Rekomandimi

Në mënyrë që të gjykohet sa më drejtë në drejtim të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes nga shoqëria të merret në mënyrë analitike familjet që kanë lidhur kontratë me OSSH Korçë dhe të spontohen me familjet që kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë. Kjo do të bëjë të mundur për të nxjerrë në mënyrë të sakte numrin e familjeve të cilat kanë kontratë individuale me OSSH dhe kontratë të përbashkët me Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a. Korçë (familjet të cilat jetojnë në banesa private dhe të cilat kanë kontrata individuale me OSSH dhe kontrata të përbashkëta për furnizim me ujë).

Deri më 30.06.2015

25.1. Gjetja nga auditimi

Nga ana e UK Korçë nuk është marrë numri i subjekteve private në Drejtorinë e Tatim Taksave të Bashkisë Korçë dhe të kryhej spontimi me listën e subjekteve që kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri.

Gjatë periudhës së auditimit në Drejtorinë e Tatim Taksave të Bashkisë u mor numri i subjekteve aktive (biznesi i madh dhe i vogël) nga ku rezultojnë të regjistruar dhe subjekteve aktive 2,570 subjekte, nga 1,822 subjekte që kanë lidhur kontratë për furnizim me ujë.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 133-139, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.2. Rekomandimi

Në mënyrë që të gjykohet sa më drejtë në drejtim të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes nga shoqëria të merret në mënyrë analitike numri i subjekteve private të regjistruar dhe që rezultojnë aktivë në Drejtorinë e Tatim Taksave të Bashkisë Korçë dhe të spontohen me subjektet private që kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë. Kjo do të bëjë të mundur për të nxjerrë në mënyrë të saktë numrin e subjekteve private që kanë lidhur kontratë me Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a. Korçë, subjektet private të cilat kryejnë aktivitetin e tyre në ambientet e banimit dhe që aktiviteti i tyre nuk e ka të nevojshme furnizimin me ujë si dhe subjektet private të cilat kanë kryer investime në hapjen e puseve (si linjat e përpunimit të mermerit, lavazhot etj).

Deri më 30.06.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën 01.01.2012-30.06.2014, është kryer pagesa për z. [REDAKTUAR] në detyrën e Kryetarit e Këshillit Mbikëqyrës në vlerën **444,436 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa

“c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 17-20 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.2. Rekomandimi

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **444,436 lekë**, përfituar nga z. [REDAKTUAR] si shpërblim për kryerjen e detyrës së Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa “c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Menjëherë

2.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën 01.01.2012-30.06.2014, është kryer pagesa për z. [REDAKTUAR] në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në vlerën **467,640 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa “c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 17-20 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2. Rekomandimi

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **467,640 lekë**, përfituar nga z. [REDAKTUAR] si shpërblim për kryerjen e detyrës së anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me VKM nr. 642 datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa c, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Menjëherë

3.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën 01.01.2012-30.06.2014, është kryer pagesa për z. [REDAKTUAR] në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në vlerën **467,640 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa “c”, Udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 17-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.2. Rekomandimi

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **467,640 lekë**, përfituar nga z. [REDAKTUAR] si shpërblim për kryerjen e detyrës së anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa c, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Menjëherë

4.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën 01.01.2012-30.06.2014, është kryer pagesa për z. [REDAKTUAR] në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në vlerën **467,640 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa “c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 17-20 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.2. Rekomandimi

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **467,640 lekë**, përfituar nga z. [REDAKTUAR] si shpërblim për kryerjen e detyrës së anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa c, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Menjëherë

5.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën 01.01.2012-30.06.2014, është kryer pagesa për z. [REDAKTUAR] në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në vlerën **467,640 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa “c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 17-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.2. Rekomandimi

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **467,640 lekë**, përfituar nga z. [REDAKTUAR] si shpërblim për kryerjen e detyrës së anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa “c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Menjëherë

6.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën 01.01.2012-30.06.2014, është kryer pagesa për zj. [REDAKTUAR] në detyrën e sekretares së Këshillit Mbikëqyrës në vlerën **189.000 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa “c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 17-20 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.2. Rekomandimi

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **189,000 lekë**, përfituar nga zj. [REDAKTUAR] si shpërblim për kryerjen e detyrës së sekretares së Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa “c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime

shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Menjëherë

7.1. Gjetja nga auditimi

Në **24 raste**, u konstatua se janë kryer shpenzime për udhëtime e dieta në **vlerën 263,245 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 54 pika 1 e neni 55 pika 1, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 94-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.2. Rekomandimi

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **263,245 lekë**, përfituar në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 54 pika 1 e neni 55 pika 1, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” nga personat sipas Aneksit nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

8.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën e auditur, bazuar në dokumentacionin e bankës për vitin 2013 kjo shoqëri është ndëshkuar me gjoba dhe **interesa për pagesë të vonuar në shumën 269,722 lekë, si rezultat i moskryerjes së detyrës së ngarkuar**, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Kreu III, neni 18, pika 1. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.2. Rekomandimi

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të merret në analizë dhe të dalë përgjegjësia administrative ndaj shkaktarëve si rezultat i moskryerjes së detyrës së ngarkuar, për dëmin e shkaktuar ndaj shoqërisë për shumën **269,722 lekë**, si rezultat i moskryerjes së detyrës së ngarkuar.

Menjëherë

9.1. Gjetja nga auditimi

Për pagesat në 2 raste të kryera nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla në shpenzimet për pritje përcjellje **me vleftë 42,100 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe për trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” ndryshuar me VKM nr. 327, datë 26.06.1996. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.2. Rekomandimi

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë të dal përgjegjësia ndaj shkaktarëve për shpenzimet për pritje përcjellje **me vleftë 42,100 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe për trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” ndryshuar me VKM nr. 327, datë 26.06.1996.

Menjëherë

10.1. Gjetja nga auditimi

Për pagesat e kryera në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 54, pika 1 e neni 55 pika 1, në 59 raste **me vleftë 653,310 lekë**, për të cilën janë kryer procedurat për blerje të vogla e të paguara nga arka, por nga ana e komisionit të blerjeve nuk

është kërkuar kuponi tatimor për çdo rast blerjeje të dalë përgjegjësia ndaj shkaktarëve. (Trajtuar më hollësisht në faqet 99-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.2. Rekomandimi

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 54, pika 1 e neni 55 pika 1, në 59 raste **me vleftë 653,310 lekë** janë kryer procedurat për blerje të vogla e të paguara nga arka, nga ana e komisionit të blerjeve nuk është kërkuar kuponi tatimor për çdo rast blerjeje, të dalë përgjegjësia ndaj shkaktarëve.

Menjëherë

11.1. Gjetja nga auditimi

Për periudhën e audituar si rezultat i moszbatimit nga ana e administratës së Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36, përsa i përket administrimit të lëvizjes së mjeteve e shpenzimeve të karburantit, si dhe të administrimit të shpenzimeve për karburantin që përdoret për ngrohje, rezulton se nuk janë justifikuar drejt shpenzimet duke krijuar **dëm ekonomik në vlerën 8,177,154 lekë**. (Trajtuar më hollësisht në faqet 152-159, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.2. Rekomandimi

Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, drejtorit të përgjithshëm, të merret në analizë dhe shqyrtim moszbatimi nga ana e administratës së Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36, përsa i përket administrimit të lëvizjes së mjeteve e shpenzimeve të karburantit, si dhe të administrimit të shpenzimeve për karburantin që përdoret për ngrohje, për **dëmin ekonomik në vlerën 8,177,154 lekë** si dhe të dalë përgjegjësia lidhur me krijimin e këtij dëmi.

Menjëherë

12.1. Gjetja nga auditimi

Nga auditimi i tenderit të prokuruar për objektin “Asfaltim i rrugës lidhëse nga aksi Korçë-Voskopojë deri tek stacioni i pompave Turan, si dhe asfaltimi i sheshit para Pallatit nr.1 dhe Pallatit nr. 3, Lagja Korçë”, përfituar më tepër **me vlerë 70.644 lekë**. (Trajtuar më hollësisht në faqet 89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.2. Rekomandimi

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të kërkohet arkëtimi i pagesës në objektin “Asfaltim i rrugës lidhëse nga aksi Korçë-Voskopojë deri tek stacioni i pompave Turan, si dhe asfaltimi i sheshit para Pallatit nr.1 dhe Pallatit nr.3, Lagja Korçë”, përfituar nga firma “**██████████**”, **me vlerë 70.644 lekë**.

Menjëherë

13.1. Gjetja nga auditimi

Në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”, pika 1, për llogarinë 231 “Aktive afatgjatë materiale në proces”, teprica kontabile e krijuar në “Projekte në proces” **me vleftë 361,607,565 lekë** në bazë të proces verbalit të datës 31.12.2013, dhe fletës kontabile nr. 25, është e shoqëruar pa faturat përkatëse ose me preventiv shpenzimesh, pasqyruar në kontabilitet në mënyrë fiktive. (Trajtuar më hollësisht në faqet 28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.2. Rekomandimi

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të dalë përgjegjësia administrative dhe ligjore se në

kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”, pika 1, për llogarinë 231 “Aktive afatgjatë materiale në proces”, teprica kontabile e krijuar në “Projekte në proces” **me vleftë 361,607,565 lekë** në bazë të proces verbalit të datës 31.12.2013 dhe fletës kontabile nr. 25, është e shoqëruar pa faturat përkatëse ose me preventiv shpenzimesh si dhe të bëhet plotësimi i dokumentacionit justifikues për këtë qëllim.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Ti rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik që në zbatim të nenit 4, 13/i dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, të vendosë ndaj Z. [REDAKTUAR] (në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor) një gjobë në vlerën 1,000,000 lekë, për të gjitha shkeljet e evidentuara në fq. 115-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe Procesverbalin nr. 2, datë 16.12.2014 të auditimit në lidhje me praktikën e kundërligjshme të lidhjes së marrëveshjes së kundërligjshme nr. 43, datë 11.02.2013 “Për Financimin dhe Instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit, me shoqërinë “[REDAKTUAR]” sh.p.k. me një vlerë investimi të realizuar prej 602,614,194 lekë për vendosjen e 22,000 matësve të ujit.

D. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenet 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe në zbatim të nenit 17, të Kontratës Kolektive të Punës, ti rekomandojmë drejtorit të shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. “Vërejtje me shkrim” për,

1. **Zj.** [REDAKTUAR], me detyrë Mbikëqyrëse e Shërbimit me Publikun, në Departamentin Administrativ.
2. **Z.** [REDAKTUAR], me detyrë Supervizor Mekanik në Sektorin e Prodhimit dhe Magazinimit të Ujit, në Departamentin e Shërbimeve Ujësjiellës.
3. [REDAKTUAR] me detyrë Teknik Humbjesh në Departamentin e Shërbimeve Ujësjiellës dhe
4. [REDAKTUAR], me detyrë Supervizor i Rrjetit Ujësjiellës në Departamentin e Shërbimeve Ujësjiellës.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në Relacionin shpjegues për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të hartuar nga kjo ndërmarrje dhe të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimet nr. 8, datë 27.12.2011 “Mbi miratimin e Programit Ekonomik të vitit 2012”, nr. 1, datë 24.12.2012 “Mbi miratimin e Programit Ekonomik të vitit 2013” dhe nr. 1, datë 21.03.2013 “Mbi miratimin e plan biznesit për vitet 2013-2017” **nuk** është bërë një ndjekje dhe analizë e saktë e sistemit të furnizimit me ujë e cila realizohet e gjitha në mënyrë automatike dhe monitorohet nga ujë matësit në prodhim, në rezervuarë, si dhe ato zonale në rrjetin shpërndarës.

- Për mosndjekje dhe analizë mujore të humbjeve në rrjet e cila ka bërë që të tejkalohen kufijtë e miratuar në Këshillin Mbikëqyrës kjo shoqëri ka miratuar për vitin 2012 humbjet në rrjet në masën prej 15 % dhe në fakt janë realizuar 28,32 % dhe për vitin 2013 humbjet në

rrjet nga 22,8 % të planifikuara në fakt janë realizuar 25,47 %, kurse për 9/mujorin janë realizuar 26,5 %.

- Për vitet proces auditimi nuk është bërë bilanci i ujit të dalë nga 2 rezervuarët e grumbullimit të ujit pranë stacionit të pompimit, i cili pompohet në dy linja tubacionesh transmetimi paralele me diametër DN 400 mm dhe me gjatësi rreth 6 km secili tubo gize sferoidale për në 3 rezervuarët në kodrat e qytetit të Korçës. Pra nuk është llogaritur humbja në rrjet e linjave të transmetimit (bilanci dalje nga rezervuarët e ujit në prodhim me hyrjen në 3 rezervuarët në kodrat e qytetit). Kjo do të bënte të mundur për të matur humbjen e sasisë së ujit në rrjetin e transmetimit.

- Nuk është matur dhe llogaritur sasia e ujit për të bërë pastrimin e rezervuarëve në kodrat e **qytetit**.

- Nuk është llogaritur sasia e ujit në dalje nga 3 rezervuarët në kodrat e qytetit në rrjetin **shpërndarës** për qytetin e Korçës, për fshatin Turan dhe fshatin Çiflig **dhe sasisë** së faturuar për të llogaritur saktësisht sasinë e humbjes së ujit në rrjetin e shpërndarjes, në këto fshatra.

- Nga UK Korçë nuk është marrë numri i familjeve në Gjendjen Civile të Bashkisë Korçë, për të bërë të mundur gjykimin sa më të drejtë në drejtim të humbjeve në rrjet si pasojë e konsumit të ujit nga familjarët pa kontratë.

Gjatë periudhës së auditimit u mor numri i familjeve në Gjendjes Civile të Bashkisë Korçë nga ku rezulton prej 28,343 familje, nga të cilat rezulton se me UKK për vitin 2012 janë lidhur 19,661 kontrata për vitin 2013 janë lidhur 19,875 kontrata dhe për 9/mujorin janë lidhur 20,123 kontrata.

- Nga UK Korçë nuk është marrë numri i familjeve që kanë lidhur kontratë me OSSH, kjo të krahasohesh me numrin e familjeve që kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri, për të bërë të mundur gjykimin sa më të drejtë në drejtim të humbjeve në rrjet si pasojë e konsumit të ujit nga familjarët pa kontratë.

- Nga UK Korçë nuk është marrë informacion për numrin e familjeve në bazë komune (Për fshatrat Turan dhe Çiflig) për të bërë të mundur spontimin me familjet që kanë lidhje me rrjetin e ujësjellësit dhe kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri.

- Nga ana e UK Korçë nuk është marrë numri i subjekteve private Drejtorinë e Tatim Taksave të Bashkisë Korçë dhe të kryhej spontimi me listën e subjekteve që kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri.

Gjatë periudhës së auditimit në Drejtorinë e Tatim Taksave të Bashkisë u mor numri i subjekteve aktive (biznesi i madh dhe i vogël) nga ku rezultonin të regjistruar dhe subjekteve aktive 2,570 subjekte, nga 1,822 subjekte që kanë lidhur kontratë për furnizim me ujë.

5. [REDAKTUAR] me detyrë shefe e departamentit juridik, pasi:

-Për periudhën 01.12.2012-30.06.2014, nuk ka hartuar si dhe nuk ka dërguar për miratim tek Këshilli Mbikëqyrës, programe ekonomiko-financiare vjetore.

-Nuk ka përcaktuar qartë mënyrën e llogaritjes së fondit limit. Studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse apo kontratat e mëparshme të vetë shoqërisë. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim, si dhe në disa raste ato kanë qenë të sforcuara. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë

10.01.2007, kreu V, i ndryshuar.

-Në të gjitha rastet operatorët ekonomikë fitues, i kanë sjellë dokumentet dorazi dhe të pa protokolluara apo arkivuara, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 22 “Format e Komunikimit”.

-I gjithë dokumentacioni i tenderëve është i pa protokolluar në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” neni 36, Kreu V, pika 1.

(Trajtuar më hollësisht në faqet dh, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalet nr. 26,27 datë 14.10.2014)

6. [REDAKTUAR] me detyrë ekonomiste e pagave dhe arkës, pasi:

-Për pagesat e kryera në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 54 pika 1 e neni 55 pika 1, në 59 raste **me vleftë 653,310 lekë**, për të cilën janë kryer procedurat për blerje të vogla e të paguara nga arka, por nga ana e komisionit të blerjeve nuk është kërkuar kuponi tatimor për çdo rast blerjeje të dalë përgjegjësia ndaj shkaktarëve.

-Për periudhën 01.01.2012-30.06.2014, është kryer pagesat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në vlerën **2,503,996 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa c, Udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërbllimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet dh, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalin nr.1, Akt Verifikimin nr,5 datë 14.10.2014)

b. “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna me shkrim shoqëruar me procesverbal”
për:

1. zj. [REDAKTUAR], me detyrë Menaxhere në Departamentin Administrativ, pasi:

-Në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, nuk ka bashkërenduar punën midis departamenteve dhe dërguar për miratim në Asamblenë e Aksionarit, programin ekonomik-financiar.

-Për periudhën nuk ka miratuar pasqyrat financiare të viteve ushtrimore 2012 dhe 2013 në Asamblenë e Aksionarit, përse i përket realizimit të të ardhurave, shpenzimeve materiale, fitimit, gjendjes së debitorëve, realizimin e investimeve etj, në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

-Janë kryer pagesa nëpërmjet arkës në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, germa e , Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 64.

-Në bashkëpunim dhe me departamentet e tjera nuk ka koordinuar punën për mirëadministrimin e shpenzimeve për karburant, duke përcaktuar dhe plotësuar fletë udhëtimet për çdo mjet transporti, autoveturë e mjete të tjera të rënda si eskavatorë, vinç, kaldajën, që të pasqyrojnë kilometrat e përshkruara prej tyre, cilësimin e destinacionit dhe distancave, si dhe orët e punës e normativat e harxhimit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Në zbatim të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e realizimin e programit ekonomik të zhvillimit dhe kryesisht për realizimin e investimeve të programuara, nuk është vlerësuar drejt si një tregues për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve e të rritjes së fitimit.

-Në bashkëpunim dhe me departamentet nuk ka kryer analizë të hollësishme mbi gjendjen e debitorëve, nuk ka ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit ndaj subjekteve debitore, nuk i është paraqitur për analizë të mëtejshme Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Aksionarit në kundërshtim me ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002, “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të

pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

-Në bashkëpunim dhe me degën e shitjes nuk kanë marrë në analizë rritjen e sasisë së faturuar, uljen e shkallës së humbjes, nuk ka marrë në analizë punën për rritjen e konsumatorëve nëpërmjet rritjes së numrit të kontratave si dhe rritjen e numrit të abonentëve.

-Në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”, pika 1, për llogarinë 231 “Aktive afatgjatë materiale në proces”, teprica kontabile e krijuar në “Projekte në proces” **me vleftë 361.607.565 lekë** në bazë të procesverbalit të datës 31.12.2013 dhe fletës kontabile nr. 25, ka kryer veprime kontabile fiktive e të pajustificuara me dokumente justifikuese.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalin nr. 24 datë 14.10.2014)

2. Zj. ██████████, me detyrë Supervizore e Financës dhe Kontabilitetit e shoqërisë, pasi:
Për:

-Në 8 rastet e sponsorizimeve me vleftë 1.164.000 lekë nuk ka kërkuar zbatimin e ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar

-Për periudhën janë kryer pagesa nëpërmjet arkës në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, germa e, Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 64.

-Blerjet me vlera të vogla janë kryer duke mos mbajtur parasysh regjistrin e prokurimeve me vlera të vogla për periudhën e audituar, duke mos respektuar limitin ligjor të blerjeve për grup apo artikuj prej 400 mijë lekë, për periudhën e audituar ky limit është tejkaluar sipas grupeve të mallrave apo artikujve për 8,230,672 lekë dhe për pasojë duhej të zhvilloheshin procedurat përkatëse për prokurimin e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, germa a, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2012 “Për blerjet me vlera të vogla”.

-Nuk ka bashkërenduar punën për të marrë masat e nevojshme për miradministrimin e shpenzimeve për karburant, duke përcaktuar dhe plotësuar fletë udhëtime për çdo mjet transporti, autoveturë e mjete të tjera të rënda si eskavatorë, vinç, kaldajën, që të pasqyrojnë kilometrat e përshkruara prej tyre, cilësimin e destinacionit dhe distancave, si dhe orët e punës e normativat e harxhimit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Nuk ka kryer analizë të hollësishme mbi gjendjen e debitorëve, nuk ka ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit ndaj subjekteve debitore, nuk i është paraqitur për analizë të mëtejshme Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Aksionarit në kundërshtim me ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

- Në **24 raste**, u konstatua se janë kryer shpenzime për udhëtime e dieta në **vlerën 263.245 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar neni 54 pika 1 e neni 55 pika 1, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

- Për periudhën 01.01.2012-30.06.2014, ka kryer pagesa për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në vlerën **2,503,996 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa c, Udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërbimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 6, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe

shoqëritë tregtare”.

-Nuk ka nxjerrë përgjegjësinë administrative ndaj shkaktarëve si rezultat i moskryerjes së detyrës së ngarkuar, për dëmin e shkaktuar ndaj shoqërisë për shumën **269,722 lekë** për gjoba e penaltete, si rezultat i moskryerjes së detyrës së ngarkuar nga personat shkaktarë.

-Nuk ka nxjerrë përgjegjësinë për pagesat në 2 raste të kryera nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla në shpenzimet për pritje përcjellje **me vleftë 42.100 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe për trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” ndryshuar me VKM nr. 327 datë 26.06.1996.

-Nuk ka kërkuar zbatimin e Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 54 pika 1 e neni 55 pika 1, në 59 raste **me vleftë 653,310 lekë**, për të cilën janë kryer procedurat për blerje të vogla e të paguara nga arka, nga ana e komisionit të blerjeve nuk është kërkuar kuponi tatimor për çdo rast blerjeje.

-Në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”, pika 1, për llogarinë 231 “Aktive afatgjatë materiale në proces”, teprica kontabile e krijuar në “Projekte në proces” **me vleftë 361,607,565 lekë** në bazë të procesverbalit të datës 31.12.2013, dhe fletës kontabile nr. 25, ka kryer veprime kontabile fiktive e të pajustificuara me dokumente justifikuese. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalin nr. 24,1,2,23, Akt Verifikimet nr.1,2,3,4,5, datë 14.10.2014)*

3. ██████████ me detyrë menaxher i Departamentit Inxhiniero teknik të shoqërisë,
Për:

- Nga auditimi i tenderit të prokuruar për objektin “Asfaltim i rrugës lidhëse nga aksi Korçë-Voskopojë deri tek stacioni i pompave Turan, si dhe asfaltimi i sheshit para Pallatit nr. 1, dhe Pallatit nr. 3, Lagja Korçë”, rezultoi pagesë më tepër **me vlerë 70,644 lekë**.

- Nuk ka përcaktuar qartë mënyrën e llogaritjes së fondit limit. Studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse apo kontratat e mëparshme të vetë shoqërisë. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 89-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Procesverbalin nr. 27, datë 14.10.2014)

II. Mbështetur në nenet 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe në zbatim të nenit 17, të Kontratës Kolektive të Punës, ti rekomandojmë Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Shkarkim nga detyra” të Z. ██████████ me detyrë drejtor i “Ujësjellës Kanalizime” sh.a. Korçë.

Për shkeljet e mëposhtme:

a) Lidhjen e marrëveshjes nr. 43, datë 11.02.2013 “Për Financimin dhe Instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit, me shoqërinë “██████████” sh.p.k. me një vlerë investimi të realizuar prej 602,614,194 lekë, trajtuar më hollësisht në fq. 115-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe që përbën dëm ekonomik, pasi:

– shpenzimi është kryer me kredi të marrë në kundërshtim me ligjin nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”;

– marrëveshja dhe investimi i kryer nuk i janë nënshtruar procedurave të prokurimit publik të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; dhe

– investimi është kryer në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sh.a.”.

b) Mosanalizimin dhe paraqitjen e shifrave të paargumentuara në lidhje me humbjet në rrjet të “Ujësjellës Kanalizime” sh.a, Korçë, si dhe mosmarrjen e masave tekniko-administrative për uljen e koeficientit të humbjeve në rrjet, trajtuar më hollësisht në fq. 130-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281 me shkresën nr. 687/12, datë 05.01.2015 është bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme proceduriale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë z. [REDAKTUAR], me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Korçë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Thoma Papadhimitri, Besim Sinani, Pullumb Beqiraj, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.